

ARMAND OMERI

**VËSHTRIM KRONOLOGJIK PËRMBI PËRDORIMIN
NORMATIV TË TERMINOLOGJISË NË SISTEMIN FONETIK
TË GJUHËS SHQIPE
(në sistemin e bashkëtingëlloreve)**

Termet shkencorë ose “*skanjet shkencore*”, siç i emërton prof. A. Xhuvani, janë mjete të rëndësishme në shkëmbimin e mendimit shkencor, kështu që gjuhëtarët kanë synuar pareshtur të saktësojnë terminologjinë krah për krah me zhvillimin e sotëm të mendimit shkencor gjuhësor. Përpikëria në përmbajtje dhe në formë është parakushti që termi të shprehë qartë përmbajtjen e nocionit që mbulon dhe të jetë gjymtyrë e sistemit terminologjik; përpikëria e bën me të vërtetë termin fjalë speciale. Në këtë rrugë zhvillimi kanë ecur dhe studimet në sistemin fonetik të gjuhës shqipe dhe ky punim synon të paraqesë një vështrim kronologjik përmbi terminologjinë që lidhet me emërtimin dhe me klasifikimin e tingujve, dhe më konkretisht, të bashkëtingëlloreve të gjuhës së sotme shqipe. Çështjet që do të parashatrojmë, kanë të bëjnë me klasifikimin e bashkëtingëlloreve sipas kriterëve që kanë përcaktuar fonetikanët dhe me përdorimin e termave përkatës nga studiuesit e gjuhës; bashkëpërkimet me termat ndërkombëtarë të sistemit fonetik nga gjuhët e tjera; kalket terminologjike; fjalëtermat, togjet apo togfjalëshat terminologjike.

Në artikullin *Terminologjia gjuhësore në sistemin fonetik të gjuhës shqipe, (në sistemin e zanoreve)*, mbajtur në Konferencën III Ndërkombëtare Shkencore me temë “Bashkëpunimi brendakulturor shqiptar”, më 22-23 prill 2016, në Tetovë, dhamë një panoramë të shpejtë të klasifikimit të tingujve të të folurit në gjuhësi: në *zanore* dhe në *bashkëtingëllore*; përmendëm se në gjuhën shqipe këta terma në fonetikë janë krijuar duke kalkuar latinet *vocalis* dhe *consonans*¹.

Në këtë artikull do të hedhim një vështrim kronologjik rreth përdorimit vetjak, shkencor dhe normativ të terminologjisë në sistemin fonetik të bashkëtingëlloreve të gjuhës shqipe nga ana e gjuhëtarëve shqiptarë.

¹ A. Dodi, Cilët terma të përdorim për të shprehur anën tingëllore të të folurit, “*Studime filologjike*”, nr. 2, Tiranë, 1964, f. 175.

Në veprën “*Shkronjëto e gjuhës shqip*”, 1886, Sami Frashëri i ka emërtuar bashkëtingëlloret “të përzëshme” (Riza, 1964, f. 189). Anton Xanoni në “*Gramatika Shqyp*”, 1909, i ka emërtuar “ndërzane” (Riza, 1964, f. 190). Aleksandër Xhuvani në “*Libri i gjuhës shqipe*”, 1921, i ka emërtuar “bashkëtingëllore” (Riza, 1964, f. 191). S. Riza, pas kritikës që u bën termave të krijuar e të përdorur prej Samiut, Xanonit dhe Xhuvanit, arsyeton se termi më i përshtatshëm është “bashkëtingull” për “bashkëtingëllore”. Selman Riza propozon zëvendësimin e termave *zanore* dhe *bashkëtingëllore* me termat *vetëtingull* dhe *bashkëtingull*, fjalë të krijuara nga kalkimi i termave gjermane *Selbstlaut* dhe *Mitlaut*.²

Termin “bashkëtingëllore” (konsonante) e hasim gjerësisht në punimet shkencore të kohës. A. Xhuvani e ka formuar termin “*bashkëtingëllore*” bashkë me L. Gurakuqin në shkollën Normale të Elbasanit më 1909, “...tue përkthye fjalë për fjalë nga fr. *consonne* ose ital. *consonante*...”³. Në “*Fjalorin e Bashkimit*”, 1908, f. 302 gjendet termi “ndërzanore”; në veprën e S. Q. Dakos *Gramatikë Elementare*, 1916, f. 19, gjendet termi “të pazëshme” për bashkëtingëlloret (Dodi, 1964, f. 178).

Në *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 114, gjejmë këtë përcaktim për bashkëtingëlloren: “tingull i të folurit, që përftohet kur ajri kalon një pengesë në organet e të folurit, zakonisht i shoqëruar me zhurmë dhe pa lëvizur tejzat e zërit...”⁴

Nga pikëpamja e nyjetimit, kur shqiptojmë bashkëtingëlloret, në rrugën e kalimit të ajrit krijohen pengesa, për shkak të mbylljes së plotë ose jo të plotë, që formojnë organet e të shqiptuarit në vende të ndryshme të aparatit të të folurit.⁵ A. Dodi shkruan se, në klasifikimin dhe përshkrimin e bashkëtingëlloreve nga pikëpamja e nyjetimit, mund ta përcaktojmë *organin aktiv* që merr pjesë në nyjetim dhe *vendin e formimit të pengesës*. [...] Dallojmë tri lloje pengesash që formohen nga organi aktiv: 1) *mbyllje* (ose okluzion), kur organi aktiv e mbyll plotësisht rrugën e kalimit të ajrit; 2) *shteg*, kur organi aktiv i afrohet organit pasiv, por

² S. Riza, “Si duhen emërtuar shqip elementet e parë të anës shqiptimore të të folurit si dhe dy grupet e tyre më kryesore”, *Studime filologjike*, nr. 1, Tiranë, 1964, f. 191.

³ A. Xhuvani, *Thërrmija gjuhe*, Botim i Akademisë së Shkencave, Vepra 2, Tiranë, 1990, f. 255. Është marrë nga A. Xhuvani, *Studime gjuhësore*, 1956, f. 47-98, shtypur në gazetën e kohës 1942 e 1944.

⁴ Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 114.

⁵ A. Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 35.

midis tyre mbetet një rrugë kalimi, ku fërkohet ajri; 3) *dridhje*, kur organi aktiv i afrohet dhe i largohet organit pasiv⁶.

Për arsye të konceptimit të këtij artikulli, gjuhëtarët, studimet e të cilëve kemi hulumtuar, i kemi ndarë në dy grupe: si kriter kemi vendosur përdorimin e terminologjisë së huaj ose të terminologjisë në gjuhën shqipe; përdorimin e terminologjisë së njëjtë ose të ndryshme për të njëjtat bashkëtingëllore ose grup bashkëtingëlloresh.

I. Duke u nisur nga kriteri “*sipas mënyrës së kapërcimit të pengesës (mënyrës së formimit)*”⁷ apo nga “*mënyra e formimit të pengesës*”⁸ ose sipas “*mënyrës së formimit të zhurmës ose llojit të pengesës*”⁹ bashkëtingëlloret ndahen në mbylltore (okluzive), shtegore (frikative), dridhëse (vibrante)¹⁰.

I. a) Në punimet shkencore që kemi hulumtuar për bashkëtingëlloret mbylltore (okluzive) *p, b, t, d, c, x, ç, xh, q, gj, k, g* studiuesit kanë përdorur këta terma: A. Xhuvani: “okluzivi”, “okluzivi labial” (*m*), “okluzivi homorganik” (*b, d, g*) (në fjalorin *The Random House Dictionary*, by Ballantine Books, 1978, fjala “organic” ka një nga kuptimet: “i karakterizuar nga një organizim, rregullim sistematik i pjesëve”, f. 632); E. Çabej: “okluziv”, “okluziv i zëshëm”; I. Ajeti: “okluzivja” (*g*); T. Dizdari: “okluziv dental” (*t*). Këta studiues përdorin termin e huaj “okluziv” për bashkëtingëlloret mbylltore, kurse termin e kalkuar në gjuhën shqipe “bashkëtingëllore mbylltore” nuk e gjejmë në studimet e këtij brezi apo grupi studiuesish. Në “*Fjalori i termave të gjuhësisë*”, 1975, që në këtë artikull do ta shkruajmë FTGJ, 1975 dhe në *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*, 2011, që në këtë artikull do ta shkruajmë FKGTJ, 2011 e gjejmë termin “bashkëtingëllore mbylltore”. Vite më vonë termin “bashkëtingëllore mbylltore” e hasim te B. Beci (Beci, 1985, f. 95; Beci, 2004, f. 23), A. Dodi, A. Jubani-Bengu.

Hapja e menjëhershme e pengesës quhet *shpërthim* dhe bashkëtingëlloret e këtij tipi quhen *shpërthyes* ose të *çastit*, p.sh. *p, b, t, d, q, gj, k, g*¹¹. Vetëm në punimin e J. Gjinarit kemi gjetur termin “bashkëtingëllore pëlçitëse” (Gjinari, 1964, f. 103), sinonim me termin “shpërthyes” të

⁶ A. Dodi, *vep. e cit.*, f. 36.

⁷ B. Beci, *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Tiranë, 2004, f. 23.

⁸ A. Dodi, *vep. e cit.*, f. 36.

⁹ A. Dodi, *vep. e cit.*, f. 73.

¹⁰ A. Dodi, *vep. e cit.*, f. 73.

¹¹ A. Dodi, *vep. e cit.*, f. 74.

përdorur nga A. Dodi. Në FTGJ, 1975 dhe në FKTGJ, 2011 gjejmë të listuar termin “bashkëtingëllore shpërthyes”.

I. b) Hapja e ngadalshme, graduale¹² e pengesës bën që organet e nyjetimit të kalojnë nga mbyllja në shteg dhe bashkëtingëlloret e këtij tipi quhen *afrikate*. Klasifikimi dhe termat për bashkëtingëlloret *mbylltore-shtegore* (*afrikatet*) (c, x, ç, xh) jep këtë pasqyrë: E. Çabej, I. Ajeti: “afrikatet” (c, ç); T. Dizdari: “afrikate palato alveolare” (ç). Dhe grupi i dytë i gjuhëtarëve, si: A. Dodi, B. Beci, E. Lafe, M. Totoni ka shtënë në përdorim këtë terminologji për klasifikimin e bashkëtingëlloreve *mbylltore-shtegore* (*afrikative*): “afrikatet” (c, x, ç, xh), “bashkëtingëllore afrikative” (c-x, ç-xh), “tingull afrikativ” (x, xh, ç), “tingulli afrikativ mesgjuhor i shurdhët” (h). Termin “bashkëtingëllore mbylltore-shtegore” nuk e kemi hasur në punimet studimore të konsultuara. Në FTGJ, 1975, këtë term nuk e gjejmë të formuluar kështu, por gjejmë termin njëfjalësh “afrikate”, kurse në FKTGJ, 2011 është shkruar termi “mbylltore afrikate”.

I. c) Në nyjetimin e bashkëtingëlloreve *shtegore* ose *frikative* (< lat. *fricare* – fërkoj), organi aktiv afrohet me pasivin, duke formuar kështu një shteg, nëpërmjet të cilit del rryma e ajrit¹³. Klasifikimi dhe termat për bashkëtingëlloret *shtegore* (*frikative*) f, v, s, z, sh, zh, h, th, dh, l, ll, j japin këtë pasqyrë: A. Xhuvani: “bashkëtingëllore aspirante” (f, h), “frikative” (s), “fishkëllore”, “spirante”, “spirante interdental” (th, dh), “spirantet sonore” (v, dh, gj, z); E. Çabej: “spiranti”, “spirant gutural”, “spiranti palatal”, “spirant velar”, “spirant velar i zëshëm”; I. Ajeti: “sibilante” (fishkëllore); K. Cipo: “fërshëllore dentale” (s); T. Dizdari: “aspirante” (h), “spiranti” (sh, v), “spiranti labiodental” (f, v), “spiranti labiodental i zëshëm” (v), “spiranti labiodental i pazëshëm” (f), “spiranti velar”, “spiranti palatal” (j), “spiranti i mesëm” (zh), “sibilanti mesor” (z), “sibilanti i tingullt” (z) (*zahire*), “sibilanti i shurdhët” (s) (*sevap*, *siklet*). Në këtë pasqyrë për bashkëtingëlloret shtegore (frikative) bie në sy përdorimi i terminologjisë nga gjuhët e huaja: “aspirante”, “spirante”, “sibilante”, “frikative”, të cilat herë nxjerrin në pah tiparin e fërkimit, herë atë të frymëtimimit ose të fërshëllimës dhe janë kalkuar me termat “shtegore”, “fishkëllore”. Për termin “spirante”, “aspirante” (shqip. *e frymëtuar*) në FTGJ, 1975 dhe në FKTGJ, 2011 gjejmë termin “bashkëtingëllore e aspiruar”, “bashkëtingëllore e frymëtuar”. Për termin “bashkëtingëllore frikative” në FTGJ, 1975 dhe në FKTGJ, 2011 gjejmë termin e kalkuar

¹² A. Dodi, *vep. e cit.*, f. 74.

¹³ A. Dodi, *vep. e cit.*, f. 74.

“bashkëtingëllore fërkimore”, kurse për termin “sibilante” (shqip. *fishkëllore*) gjejmë termin “bashkëtingëllore fishkëllore”.

Grupi i dytë i gjuhëtarëve ka shtënë në përdorim këtë terminologji për klasifikimin e bashkëtingëlloreve *shtegore (frikative)* *f, v, s, z, sh, zh, h, th, dh, l, ll, j*: B. Beci: “frikativet” (*s, sh, zh*), “bashkëtingëllorja mesgjuhore frikative” (*j*), “bashkëtingëllore fërkimore” (*f, v, th, dh, s, z, sh, zh, h, j*); E. Lafe: “frikativi” (*sh, zh*), “bashkëtingëllore spirante” (*s*); L. Dodbiba: “frikativi”, “frikativi qiellzor”, “frikativi palatal” (*zh*); M. Domi, Dh. Shuteriqi: “bashkëtingëllore fërshëlyese” (*s, z*); M. Totoni: “bashkëtingëllore fishkëlyese” (*s, z*), “tingull frikativ i zëshëm” (*z*), “tingull frikativ i shurdhët”, “tingull frikativ i shurdhët mesgjuhor”, (“spirant palatal”) (*h'edh, ah'ere, mah'ere*), “tingull frikativ i zëshëm prapagjuhor” (“spirant velar”) (*si γ* e greqishtes: *γ*arufo, *Garufo*).

Në tërësi studiuesit i klasifikojnë bashkëtingëlloret e këtij grupi me termin “frikativet” dhe tiparet e veçanta tingëllore të secilës prej bashkëtingëlloreve i karakterizojnë dhe me termin që shënon veçoritë e tingullit, si: “fishkëllore”, “fishkëlyese”, “i frymëtuar”, “qiellzor”, “velar”.

I. ç) Sipas vendit të shtegut, bashkëtingëlloret shtegore mund të jenë *mesore* dhe *anësore*. Bashkëtingëlloret *anësore* ose *laterale* në gjuhën shqipe janë *l, ll*. Bashkëtingëlloret e tjera shtegore janë *mesore: f, v, s, z, sh, zh, h, th, dh, j*¹⁴. Gati të gjithë studiuesit përdorin termin “likuide” për klasifikimin e bashkëtingëlloreve shtegore *anësore (l, ll)*: A. Xhuvani: “likuida”; E. Çabej: “disimilim likuidesh” (*gjarpër* për *gjarpër*); L. Dodbiba: “likuidet”; T. Dizdari: “likuide velare” (*l, ll*). Studiuesi I. Ajeti bashkëtingëlloren *ll* e emërton “velare” dhe me termin shqip “rrotullare” (*ll*). Po t'i referohemi A. Dodit, do të shkruajmë se bashkëtingëllorja *l* e shqipes nuk karakterizohet as nga palatalizimi, as nga velarizimi¹⁵, kurse te *ll* velarizimi është nyjëtim plotësues i tingullit¹⁶.

Dhe grupi i dytë i studiuesve bën po këtë klasifikim; përdor po këtë terminologji të huaj për bashkëtingëlloret shtegore *anësore*; vetëm se në këtë grup të vogël bashkëtingëlloresh disa nga studiuesit kanë përfshirë dhe bashkëtingëlloret dridhëse *r, rr*, kurse termin “anësore” e ka përdorur vetëm B. Beci (Beci, 1985, f. 95). M. Domi dhe Dh. Shuteriqi vënë në përdorim kalkun terminologjik “lëngëtore” (Domi, Shuteriqi, 1965, f. 106). Te “likuidet” ose “lëngoret” gjuha formon një mbyllje të pjesshme të gojës ose të grykës, rryma e ajrit pengohet, por jo aq sa të ndërpritet ose të

¹⁴ A. Dodi, *vep. e cit.*, f. 74.

¹⁵ A. Dodi, *vep. e cit.*, f. 83.

¹⁶ A. Dodi, *vep. e cit.*, f. 84.

krijojë fërkim. Ndoshta këto karakteristika nyjëtimore bëjnë që *l, ll, r, rr* të quhen “likuide”. A. Dodi: “likuidet”, “bashkëtingëllore likuide”; B. Beci: “bashkëtingëllore likuide” (*l, ll, r, rr*), “bashkëtingëllore anësore” (*l, ll*); E. Lafe: “bashkëtingëllore likuide” (*r, rr, l, ll*); J. Gjinari: “bashkëtingëllore likuide”; M. Domi dhe Dh. Shuteriqi: “bashkëtingëllore lëngëtore” (*l*), “bashkëtingëllore lëngëtore velare” (*ll*); M. Totoni: “bashkëtingëllore likuide”, “tinguj likuidë” (*r, ll, l*); A. Jubani-Bengu: “anësoret” (*l, ll*). Në FTGJ, 1975 dhe në FK TGJ, 2011 gjejmë termin “bashkëtingëllore anësore”, “bashkëtingëllore e lëngët”.

I. d) Te bashkëtingëlloret shtegore dallojmë dhe një grup bashkëtingëlloresh, që emërtohen me termin “mesore” ose “aproksimante”. A. Xhuvani përdor termin “gjysmëzanore” (e tillë është *j*-ja) dhe ky term na afron me termin “aproksimante”. A. Jubani në punimin e saj përdor termat “mesoret” ose “aproksimantet” për të emërtuar bashkëtingëlloret *j, r*. “Ladefoged (1964) ka qenë i pari që përdori termin “approximant” në *Phonetic Study of West African Languages*, siç vë në dukje Eugenio Martínez-Celdrán.”¹⁷ Aproximantet (angl. *approximante* – i përafërt) janë bashkëtingëlloret, që tingëllojnë në disa raste si zanore dhe gjysmëzanoret *j, r*. Gjatë hulumtimit mbi punimet studimore, që kemi përdorur për këtë artikull, termi “aproksimantet” nuk del pothuajse fare. Termi “aproksimante” nuk del as në dy fjalorët e termave të gjuhësisë.

I. e) Bashkëtingëlloret *dridhëse* (vibrante) në gjuhën shqipe janë tingujt *r* dhe *rr*. Klasifikimi dhe terminologjia për bashkëtingëlloret dridhëse na jep këtë listë termash: A. Dodi dhe M. Totoni i klasifikojnë *r, rr* me termin “dridhëse”: “bashkëtingëllore dridhëse” (*r, rr*), “bashkëtingëllore dridhëse e gjatë” (*rr*); B. Beci i klasifikon bashkëtingëlloret *r, rr* si “likuide” (Beci, 1964, f. 158), por më pas i quan “bashkëtingëllore dridhëse” (Beci, 2004, f. 23). Dhe E. Lafe bashkëtingëlloret *r, rr* i klasifikon si “likuide” (Lafe, 1965, f. 166). Në FTGJ, 1975 dhe në FK TGJ, 2011 gjejmë termin “bashkëtingëllore dridhëse”.

II. Nga pikëpamja akustike bashkëtingëlloret ndahen në të zhurmëta dhe në sonante (të tingullta)¹⁸. Bashkëtingëlloret e zhurmëta të gjuhës shqipe i ndajmë në të zëshme dhe në të pazëshme (të shurdhëta) dhe ky klasifikim e ka bazën te pjesëmarrja ose mospjesëmarrja e kordave zanore

¹⁷ A. Jubani-Bengu, *Fonetikë akustike (Analizë e sistemit fonologjik)*, Tiranë, 2012, f. 121.

¹⁸ A. Dodi, *vep. e cit.*, f. 36.

në nyjëtimin e tyre. Në studimet e tyre për fonetikën dhe për dialektologjinë e gjuhës shqipe gjuhëtarët kanë përdorur një terminologji të larmishme dhe ne kemi listuar këta terma për bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme (të shurdhëta). A. Xhuvani: “bashkëtingëllore e zëshme”, “bashkëtingëllore e pazëshme”, “bashkëtingëllore të pazëshme shurdha” (*p, t*; fr. *consonnes sourdes*), “konsonante e zëshme”, “bashkëtingëllore tingëllore” (*b, d*; fr. *sonores*), “spirantet sonore” (*v, dh, gj, z*), “sordet” (*p, t, k, f, th, q*); E. Çabej: “spirant velar i zëshëm” (*moya* për *molla*), “okluziv i zëshëm”; K. Cipo: “bashkëtingëlloret e tingullta”, “bashkëtingëlloret e shurdhëta”, “bilabiale e tingëllt” (*b*), “dentale e shurdhët” (*t*); T. Dizdari: “sibilanti i shurdhët” (*s*) (*sevap, siklet*), “sibilanti i tingullt” (*z*) (*zahire*), “spiranti labiodental i zëshëm” (*v*), “spiranti labiodental i pazëshëm” (*f*); L. Dodbiba: “velare e shurdhët” (*k*). Nga grupi i dytë i studiuesve veçojmë këta terma: B. Beci: “bashkëtingëllore të zëshme” (*dh, g, b, z, v*), “bashkëtingëllore të shurdhëta” (*th, k, p, s, f*); J. Gjinari: “bashkëtingëlloret e zëshme” (*b, g*), “bashkëtingëlloret e shurdhëta” (*p, k*); M. Domi, Dh. Shuteriqi: “bashkëtingëllore e shurdhët”; M. Totoni: bashkëtingëllore të shurdhëta, (të zëshme). Në përgjithësi, termi bazë është *i zëshëm, i pazëshëm, i shurdhët, sorde*; por gjejmë përdorimin e termave “tingëllore” (*b, d*), “i tingullt” (*b, z*) “sonore” (*v, dh, gj, z*) për të klasifikuar bashkëtingëlloret e zhurmëta të zëshme dhe këtu bie në sy kalku terminologjik i termit të huaj nga frëngjishtja “*consonne sonore*”. Më pas B. Beci me termin “bashkëtingëllore të tingullta” dhe A. Dodi me termin “bashkëtingëllore sonante (sonore) (të tingullta)” klasifikojnë një grup të caktuar bashkëtingëlloresh: *m, n, nj, j, l, ll, r, rr*. Në FTGJ, 1975 dhe në FK TGJ, 2011 gjejmë termat “bashkëtingëllore e zhurmët”, “bashkëtingëllore e zëshme”, “bashkëtingëllore e shurdhët”.

III. Bashkëtingëlloret *hundore* dhe *johundore* ndahen si të tilla në varësi të pozicionit të qiellzës së butë. Bashkëtingëlloret hundore (*m, n, nj*) janë bashkëtingëllore *sonante* (të tingullta), meqë te këto mbizotëron zëri, kurse zhurma është e dobët¹⁹. Në tërësi në terminologjinë e përdorur nga studiuesit e grupit të parë mbizotëron përdorimi i termit të huaj “nazali”, por më pas gjejmë në përdorim dhe kalkun terminologjik “bashkëtingëllore hundore”. Ky term karakterizohet nga përdorimi normativ, sepse është përdorur me një kuptim të vetëm, mbulon një koncept dhe emërton një grup bashkëtingëlloresh, që kanë si tipar të qenësishëm hundorësinë. A. Xhuvani: “nazali”, “nazali sonant”, “sonante nazale”; K. Cipo: “nazalja”,

¹⁹ A. Dodi, *vep. e cit.*, f. 75.

T. Dizdari: “bilabiali nazal” (*m*), “nazali labial” (*m*), “dentali nazal” (*n*), “nazali dental” (*n*). A. Dodi: “bashkëtingëllore hundore” (*m, n, nj*); B. Beci: “bashkëtingëllore nazale”, “bashkëtingëllore hundore” (*m, n, n*); E. Lafe: “bashkëtingëllorja sonore nazale” (*nj*); Gj. Shkurtaj: “bashkëtingëllore hundore”; J. Gjinari: “bashkëtingëllore qiellzore hundore” (*nj*); M. Domi, Dh. Shuteriqi: “bashkëtingëllore hundore qiellzore” (*nj*); M. Totonj: “bashkëtingëllore hundore” (“nazale”) (*m, n, nj*). Në FTGJ, 1975 dhe në FKGTJ, 2011 gjejmë termat “bashkëtingëllore hundore”.

IV. Për klasifikimin e bashkëtingëlloreve sipas *vendit të formimit*, mbështetemi në organin aktiv, që merr pjesë në nyjëtim dhe në vendin e formimit të pengesës. Sipas *organit aktiv*, bashkëtingëlloret e shqipes ndahen në tri grupe të mëdha: 1) *buzore*, 2) *gjuhore*, 3) *glotale*²⁰.

IV. a) Në klasifikimin e bashkëtingëlloreve sipas *organit aktiv*, *buzëve*, (*p, b, f, v, m*) nga grupi i parë i studiuesve kemi listuar disa terma, ku bie në sy shpreshtia në përdorimin e termit të huaj, gjithashtu dhe terma sinonimë, të cilët përftohen nga ndërrimi i vendit të gjymtyrëve në togfjalëshin terminologjik, si dhe nga përdorimi i termit të huaj dhe të kalkuar: A. Xhuvani: “bilabiale” (*p, b*), “labiodentale”; T. Dizdari: “bilabiali”, “bilabiali nazal” (*m*), “nazali labial” (*m*), “labiodental”, “dybuzori” (*p, b*); K. Cipo: “bilabiale e tingëllt” (*b*). Tek grupi i dytë i studiuesve vihet re përdorimi i termave të kalkuar në gjuhën shqipe. M. Domi, Dh. Shuteriqi, B. Beci, E. Lafe, Gj. Shkurtaj, J. Gjinari, L. Dodbiba përdorin termat: “bashkëtingëllore labiale”, “bashkëtingëllore buzore”, “bashkëtingëllore buzore-dhëmbore” (*f, v*). Në FTGJ, 1975 dhe në FKGTJ, 2011 kemi gjetur termat “bashkëtingëllore buzore”, “bashkëtingëllore buzodhëmbore”, bashkëtingëllore dybuzore”.

IV. b) Klasifikimi i bashkëtingëlloreve mbështetet dhe në *organin aktiv*, *gjuhën*. Në punimet shkencore të grupit të parë të gjuhëtarëve nuk kemi ndeshur në klasifikimin e bashkëtingëlloreve të gjuhës shqipe mbi bazën e organit aktiv të gjuhës e për rrjedhojë nuk kemi listuar terma gjuhësorë mbi këtë kriter. Gjuhëtarët nuk i kanë parë bashkëtingëlloret mbi këtë kriter klasifikimi. Në punimet e grupit të dytë të studiuesve kemi veçuar disa terma që mbajnë parasysh këtë kriter. Kështu B. Beci emërtonte “bashkëtingëllore paragjuhore” (*ç, xh*), “paragjuhore dhambore” (*t*), “paragjuhore sonore” (*rr*); “mbrapagjuhore (velare)” (*h, k, g, gj*); “mesgjuhore frikative” (*j*), “mesgjuhore” (“palatale”) (*q, gj*), “mesgjuhore sonore” (“palatale”) (*nj*). Nga një shikim i shpejtë, vërejmë se termat

²⁰ A. Dodi, *vep. e cit.*, f. 72.

mbajnë dhe tipare të tjera të bashkëtingëlloreve, të cilat shërbejnë për sisteme të tjera klasifikimi e për pasojë do të kemi një sistem të ndërlikuar të terminologjisë në këtë pjesë të fonetikës. Klasifikimin me termat “bashkëtingëllore paragjuhore”, “bashkëtingëllore prapagjuhore”, “bashkëtingëllore mesgjuhore” e specifikon A. Dodi (Dodi, 2004, f. 72). Ai shkon më tej në klasifikimin e bashkëtingëlloreve, kur mbështetet te organi aktiv, gjuha me termat “bashkëtingëllore paragjuhore majore” (“apikale”), “kulmore” (“kakuminale”), “bashkëtingëllore mesgjuhore shpinore” (“dorsale”) (Dodi, 2004, f. 72, 73). Në FTGJ, 1975 dhe në FKTGJ 2011 gjejmë termat “bashkëtingëllore paragjuhore”, “bashkëtingëllore prapagjuhore”, “bashkëtingëllore mesgjuhore”, “bashkëtingëllore shpinore”. Në FKTGJ, 2011 barazohet termi “bashkëtingëllore mesgjuhore ose shpinore”, kemi të shënuar të njëjtin koncept ose nocion, por që emërtohet me fjalë-terma të ndryshëm, pra, një sinonimi terminologjike.

IV. c) Në klasifikimin e bashkëtingëlloreve sipas *organit aktiv, glotës apo laringut*, bashkëtingëllorja *h* klasifikohet si glotale ose laringale. Por gjuhëtarët e grupit të parë nuk kanë mbajtur parasysh tiparin sipas organit aktiv, glotës (shtegthit) apo laringut, prandaj gjejmë këtë terminologji për bashkëtingëlloren *h*: A. Xhuvani: “bashkëtingëllore aspirante” (*h*); E. Çabej: “spirant gutural” (shqiptimi i *h*-së: *i xuaj*); T. Dizdari: “aspirante” (*h*); M. Totoni: “tingull frikativ i shurdhët mesgjuhor” (“spirant palatal”) (*h’edh, ah’ere, mah’ere*). Gjuhëtarët e grupit të dytë përdorin termat klasifikues duke u mbështetur mbi këtë tipar. B. Beci: “bashkëtingëllore glotale” (“laringale”) (*h*); E. Lafe: “bashkëtingëllorja faringale” (*h*); J. Gjinari: “bashkëtingëllore grykore” (*h*), “bashkëtingëllore faringale” (*h*). Në FTGJ, 1975 gjejmë termin “bashkëtingëllore laringale” dhe “glotale” (shtegthore), por jo në zërin e termave “bashkëtingëllore”, kurse në FKTGJ, 2011 gjejmë termin “bashkëtingëllore shtegore (glott(id)ale)”.

V. Sipas *organit pasiv* përcaktohet vendi ku formohet pengesa.

V. a) Për bashkëtingëlloret *paragjuhore* listojmë këtë terminologji: 1) pengesa midis alveolave dhe dhëmbëve (*t, d, ll*): K. Cipo: “dentale e shurdhët” (*t*), “fërshëllore dentale” (*s*); T. Dizdari: “dentali” (*d*), “dentali nazal” (*n*); B. Beci: “bashkëtingëllore alveodhëmbore” (*t, d, ll*); J. Gjinari, M. Domi, Dh. Shuteriqi: “bashkëtingëllore dhëmbore” (*t*); Në FTGJ, 1975 dhe në FKTGJ, 2011 gjejmë termin “bashkëtingëllore dhëmbore”; 2) pengesa te alveolat (*c, x, s, z, n, l, r, rr*): K. Cipo: “alveodentale gjysmëokluzive” (*c*); A. Dodi, B. Beci përdorin termin “bashkëtingëllore alveolare” (*n, l, c, x, s, z, r, rr*). Në FTGJ, 1975 dhe në FKTGJ, 2011

gjejmë termin “bashkëtingëllore trysores” për “alveolare”, ku fjala “trysa – mish i dhëmbëve” është ngritur në term; 3) pengesa midis dhëmbëve të sipërm dhe të poshtëm (*th, dh*): A. Xhuvani: “spirante interdental” (*th, dh*); T. Dizdari: “interdentali” (*th, dh*); A. Dodi, B. Beci, E. Lafe, M. Domi, Dh. Shuteriqi shkruajnë “bashkëtingëllore ndërthëmbore” (*th, dh*). Në FTGJ, 1975 dhe në FKTGJ, 2011 ndeshim termin “bashkëtingëllore ndërthëmbore”;

4) pengesa midis alveolave dhe fillimit të qiellzës së fortë (*ç, xh, sh, zh*), ndryshe këto bashkëtingëllore klasifikohen si paraqiellzore. T. Dizdari: “afrikate palato alveolare” (*ç*); L. Dodbiba: “frikativi qiellzor” (“palatale”) (*zh*); B. Beci: “palatalo-alveolare” (“qiellzore-alveolare”) (*ç, xh, sh, zh, rr*). Në FTGJ, 1975 dhe në FKTGJ, 2011 ndeshim termin “bashkëtingëllore qiellzotrysores”.

V. b) Bashkëtingëlloret *mesgjuhore* (*q, gj, nj, j*) quhen dhe *qiellzore* (*palatale*) ose *mesqiellzore*²¹. Studiuesit e grupit të parë kanë përdorur termin “palatalet”, por nuk kanë pasur parasysh gjithnjë po ato bashkëtingëllore, të cilat sot klasifikohen si të tilla. A. Xhuvani përdor termin “palatale” dhe “guturale” për (*k, g*), “palatal i pazëshëm” (*k*). I. Ajeti: “palatale” (*l*), (Ajeti, 1970, f. 120); E. Çabej: “palatalet” (*k, g*), por ndeshim dhe “prepalatalet” (*q, gj*), “palatalizimi” (*g* shqiptohet në fjalë *gj; vegë – vegjë*), që përkojnë me klasifikimin e sotëm të këtyre bashkëtingëlloreve. T. Dizdari përdor termin që përkon me klasifikimin e sotëm të këtyre bashkëtingëlloreve: “palatale” (*q*), “spiranti palatal” (*j*).

Studiuesit e grupit të dytë përdorin termat klasifikues, që përkojnë me këtë grup bashkëtingëlloresh. B. Beci, Gj. Shkurtaj, M. Totonj përdorin terma të huaj dhe kalke terminologjike. Termat me tri gjymtyrë synojnë të japin më shumë tipare e karakteristika nyjetimore për bashkëtingëlloret dhe shënojnë një nga bashkëtingëlloret e grupit, ku bën pjesë, kurse termi me dy elementë termformues është më i përgjithshëm dhe përfshin brenda tij dy a më shumë bashkëtingëllore. Kështu në punimet e B. Becit kemi listuar termat “bashkëtingëllore mesgjuhore”, “palatale”, “qiellzore” (*q, gj*), “bashkëtingëllore qiellzore” (*q, gj, nj, j*), “bashkëtingëllorja mesgjuhore sonore” (*nj*), kurse J. Gjinari shkruan “bashkëtingëllore qiellzore hundore” (*nj*); E. Lafe: “bashkëtingëllore qiellzore”, “palatale” (*q, gj*); Gj. Shkurtaj: “sonantja palatale” (*nj*), “tingull okluziv paraqiellzor” (*q, gj*), kurse A. Dodi për këtë klasifikim përdor termin “mesqiellzor”; J. Gjinari: “bashkëtingëllore qiellzore”, “bashkëtingëllore qiellzore hundore”

²¹ A. Dodi, *vep e cit.*, f. 73.

(nj); M. Domi, Dh. Shuteriqi: “bashkëtingëllore hundore qiellzore” (nj); M. Totoni: “tingull palatal” (q, gj), “tingull palatal i shurdhët” (q), “tingull palatal i zëshëm” (gj). Në FTGJ, 1975 dhe në FKGTJ, 2011 gjejmë termin “bashkëtingëllore qiellzore”.

V. c) Bashkëtingëlloret *prapagjuhore* (k, g) quhen dhe *velare*²² (qiellza e butë) ose *prapaqiellzore* dhe sipas këtij kriteri listojmë këtë terminologji të përdorur nga studiuesit tanë. Grupi i parë i studiuesve priret drejt përdorimit të termave të huaj. Bashkëtingëlloret *k, g* quhen “guturale”, “palatale”, “velare”. A. Xhuvani përdor termin “guturale”, “palatale” (k, g), “palatal i pazëshëm” (k); E. Çabej: “palatalet” (k, g), “tingull gutural” (grykor); I. Ajeti dhe T. Dizdari: “guturale”, “guturale velare” (k); L. Dodbibaj: “velare” (k), “velare e shurdhët” (k). Grupi i dytë i studiuesve përdor kalket terminologjike dhe i quan bashkëtingëlloret *k, g, h* “grykore”, “prapaqiellzore”, “mbrapagjuhore”. B. Beci, E. Lafi, Gj. Shkurtaj, J. Gjinari, M. Domi, Dh. Shuteriqi përdorin termin: “bashkëtingëllore grykore” (k, g, h); B. Beci i klasifikon dhe si “bashkëtingëllore mbrapagjuhore”, (k, g, h, gj), “velare”, “tingull grykor” (k, g, h), “bashkëtingëllore prapaqiellzore”. Vëmë re se studiuesit përdorin termin e huaj dhe termin në gjuhën shqipe: “guturale – grykore”, “palatale”, “velare – prapaqiellzore – prapagjuhore”. Bashkëtingëlloret (k, g) janë edhe grykore, edhe prapaqiellzore, edhe prapagjuhore. Në FTG, 1975 gjejmë termin “bashkëtingëllore grykore”, “bashkëtingëllore prapagjuhore”, “bashkëtingëllore prapaqiellzore ose velare”, kurse në FKGTJ, 2011 pasqyrohet vetëm termi “bashkëtingëllore prapaqiellzore ose prapagjuhore”.

Përfundime

Terminologjia për klasifikimin e bashkëtingëlloreve në gjuhën shqipe mban gjurmët e kohës së studimeve dhe formimin shkencor e kulturor të studiuesve. Në grupin e parë të studiuesve bie në sy përdorimi i terminologjisë në gjuhë të huaj, kurse në brezin e dytë të gjuhëtarëve vihet re përdorimi i terminologjisë së huaj dhe i kalkeve terminologjike në gjuhën shqipe. Tërësia e studimeve solli padyshim thellimin e dijeve në studimet gjuhësore dhe pasurimin e njohurive shkencore, gjithashtu dhe pasurimin e fjalorit terminologjik të gjuhësisë.

Gjatë hulumtimit në artikujt dhe studimet e gjuhëtarëve kemi hasur terma të huaj, që për një kohë të gjatë nuk janë zëvendësuar me termat në gjuhën shqipe, madje nuk i kemi gjetur as në dy fjalorët e termave të

²² A. Dodi, *vep. e cit.*, f. 73.

gjuhësisë, me të cilët u konsultuam në këtë artikull. Mendojmë se jo çdo term mund të kalkohet në gjuhën shqipe, sidomos ata që klasifikohen si terma ndërkombëtarë. Në listën e termave kemi renditur terma të huaj: “guturale”, “guturalet velare”; terma të përzier shqip dhe të huaj ose terma hibridë²³: “palatal i pazëshëm”, “velare e shurdhët”, “bashkëtingëllore alveodhëmbore” dhe terma të kalkuar në gjuhën shqipe: “bashkëtingëllore hundore qiellzore”, “bashkëtingëllore buzore-dhëmbore”.

Në klasifikimin e disa bashkëtingëlloreve dhe në përdorimin e termave përkatës gjuhëtarët janë nisur nga tipare të ndryshme dhe kjo ka përcaktuar përdorimin e termave dhe të terminoelementëve të ndryshëm si në rastin e bashkëtingëlloreve shtegore (frikative) ku bie në sy përdorimi i terminologjisë nga gjuhët e huaja: “aspirante”, “spirante”, “sibilante”, “frikative”, të cilat herë nxjerrin në pah tiparin e fërkimit, herë atë të frymëtimit ose të fërshëllimës dhe janë kalkuar me termat “shtegore”, “fishkëllore”.

Në punimet studimore, që kemi hulumtuar për këtë artikull, termi “aproksimantet” nuk del pothuajse fare. Termi “aproksimante” nuk del as në dy fjalorët e termave të gjuhësisë.

Në përgjithësi gjuhëtarët përdorin termin *i zëshëm*, *i pazëshëm*, *i shurdhët*, *sorde* për klasifikimin e bashkëtingëlloreve nga pikëpamja akustike, por ndeshim dhe në përdorimin e termave “tingëllore” (*b*, *d*), “i tingullt” (*b*, *z*) “sonore” (*v*, *dh*, *gj*, *z*) për të klasifikuar bashkëtingëlloret e zhurmëta të zëshme.

Në punimet shkencore të grupit të parë të gjuhëtarëve nuk kemi ndeshur në klasifikimin e bashkëtingëlloreve të gjuhës shqipe mbi bazën e organit aktiv të gjuhës e për rrjedhojë nuk kemi listuar terma gjuhësorë mbi këtë kriter. Gjuhëtarët nuk i kanë parë bashkëtingëlloret mbi këtë kriter klasifikimi.

BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave e RPSH (1975), *Fjalor i termave të gjuhësisë shqip-rusisht-frëngjisht-anglisht-gjermanisht-italisht*, Tiranë.
Akademia e Shkencave e RPSSH (1980), *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë.

²³ F. Leka, “Aspekte të zhvillimit të terminologjisë tekniko-shkencore pas Çlirimit”, *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, II, Tiranë, 1972, f. 199.

- Akademia e Shkencave e RPSSH (1984), *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë.
- Beci, B. (1964), “E folmja e Reç-e-Dardhës së Dibrës” (I), *Studime filologjike*, nr. 4, Tiranë.
- Beci, B. (1984), “Sistemi i zanoreve hundore në të folmen e Shkodrës”, *Studime filologjike*, nr. 2, Tiranë.
- Beci, B. (1985), “Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe norma fonetike”, *Studime filologjike*, nr. 1, Tiranë.
- Beci, B. (2004), *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Tiranë, Botimet “EDFA”.
- Belluscio, G., Rrokaj, Sh. (2011), *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë (shqip-italisht-frëngjisht-anglisht)*. Arcavacata di Rende – Tiranë, Arbëria.
- Cipo, K.(1964), “Një sy rreth dorëshkrimit të Simonit”, “*Studime filologjike*”, nr. 1, Tiranë.
- Çabej, E. (1967), “Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XXIV”, *Studime filologjike*, nr. 1, Tiranë.
- Çabej, E. (1967), “Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XXV”, *Studime filologjike*, nr. 2, Tiranë.
- Çeliku, M. (1964), “Rotacizmi në të folmet kalimtare të gjuhës shqipe”, *Studime filologjike*, nr. 1, Tiranë.
- Dizdari, T. (1964), “Huazime orientalizmesh”, *Studime filologjike*, nr. 2, Tiranë.
- Dodbiba, L. (1972), “Leksiku i sotëm detar i shqipes dhe elementet e tij të pahuazuara”, *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, II, Tiranë.
- Dodi, A. (1964), “Cilët terma të përdorim për të shprehur anën tingëllore të të folurit”, *Studime filologjike*, nr. 2, Tiranë.
- Dodi, A. (1967), “Rreth sistemit vokalik të shqipes”, *Studime filologjike*, nr. 3, Tiranë.
- Dodi, A. (2004), *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- Gjinari, J. (1964), “Vëzhgime mbi të folme të Krujës dhe të Malësisë së Krujës”, *Studime filologjike*, nr. 3, Tiranë.
- Gjinari, J. (1964), “Vëzhgime mbi të folme të Krujës dhe të Malësisë së Krujës”, II, *Studime filologjike*, nr. 4, Tiranë.
- Jubani, A. (2012), *Fonetikë akustike - Analizë e sistemit fonologjik*, Tiranë.

- Lafe, E. (1964), “E folmja e Nikaj-Mërturit”, *Studime filologjike*, nr. 3, Tiranë.
- Lafe, E. (1965), “Trajtat e urdhërores te Gjon Buzuku”, *Studime filologjike*, nr. 1, Tiranë.
- Leka, F. (1972), “Aspekte të zhvillimit të terminologjisë tekniko-shkencore pas çlirimit”, *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, II, Tiranë.
- Shkurtaj, Gj. (1967), “E folmja e Kastratit”, *Studime filologjike*, nr. 2, Tiranë.
- Totoni, M. (1967), “E folmja e Bregdetit të Poshtëm”, *Studime filologjike*, nr. 1, Tiranë.
- Xhuvani, A., *Vepra 1* (1980), Xhuvani, A., Çabej, E. *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956), Tiranë, Botim i Akademisë së Shkencave.
- Xhuvani, A. *Vepra 2* (1990), *Thërmija gjuhe*, Tiranë, Botim i Akademisë së Shkencave.
- Xhuvani, A., *Vepra 2* (1990), *Kokrra gjuhe*, Tiranë, Botim i Akademisë së Shkencave.